



01Nr. 104/02-30079 /23

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit 04/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 23 dhe 24, të Rregullores 06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Vendimit për lejimin e ndarjes së subvencioneve me 01 Nr.104/02-19090/23 dhe sipas marrëveshjeve të nënshkruara në mes dy palëve kontraktuese, Kryetari i Komunës me datë 23.11.2023 merr këtë :

**VENDIM
PËR MONITORIMIN E SUBVENCIONEVE**

I. Komisioni për monitorim të subvencioneve në kuadër të thirrjes "Gratë në Biznes" në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit do të këtë përbërje si në vijim:

- Murat Burrniku ,Kryesues i komisionit – Jurist në DAP
- Kaltrina Çaka -Anëtare e komisionit – Juriste në DSHPE
- Fadil Qallaku- Anëtar i komisionit -Ekonomist në DKA

II. Punët dhe detyrat e komisionit për monitorimin e subvencioneve do t'i kryejnë konform Rregullores 06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve .

Arsyetim

Duke e ditur rëndësinë dhe nevojën e domosdoshme për kryerjen e këtyre detyrave që i përkasin këtij vendimi është konstatuar që anëtarët e këtij komisioni janë kompetent për kryerjen me përgjegjësi të procesit të monitorimit të ndarjes së subvencioneve në kuadër të thirrjes "Gratë në Biznes" në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit .

Anëtarët e komisionit të lartcekur do të kryejnë monitorimin për ndarjen e subvencioneve në harmoni me rregulloren në fuqi , sipas vendimit me 01 Nr.104/02-19090/23 të datës 03.08.2023 për ndarjen e subvencioneve .

Komisioni do të ketë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm të secilit hap rreth ndarjes së subvencioneve : thirrjen e datës 15.06.2023 , vendimin për ndarjen e subvencioneve të datës 03.08.2023 dhe kontratat për secilin përfitues .

Kryetari i Komunës në mbështetje të legjislacionit në fuqi vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

Me këtë vendim të njoftohen:

- Kryetari i Komunës ;
- Anëtarët e komisionit ;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

